

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Cloud Tech House” Sh.p.k.**

**Z Mario Gashi**, shtetas Shqiptare, lindur me date 17.08.1992, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i pashaportes Shqiptare me nr. J20817063C.

**Z Toni Gashi**, shtetas Shqiptare, lindur me date 08.01.1999, Tirane, Shqiperi, mbajtes i kartës se identitetit Shqiptare me nr. J90108050E.

Te cilet sot me date 21 Dhjetor 2023 (dymijë e njëzete e tre), kane vendosur te nenshkruajne Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte “Shoqeria”), aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

**Neni 1 - Emertimi**

Emertimi i Shoqerise eshte “**Cloud Tech House**” Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqerise eshte ne adresen Njesia administrative nr. 8, Rruga “Ferid Xhajko”, Ndertesa 86, Tirane, Shqiperi

**Neni 3 - Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje periudhe te papercaktuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqerise**

- 4.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.  
Konkretisht kryerja e sherbimeve te programimit, IT dhe marketingu
- 4.2 Per permbushjen e objektivave te Shoqerise, kompania mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, te luajtshme dhe te paluajtshme qe perbejne nje gje te pershtatshme, mund te zoterojne aksione ne kompani te tjera, biznese, shoqata dhe konsorciume te cilat kane objekt aktiviteti te njejte apo te ngjashem.
- 4.3 Shoqeria mund te marre hua dhe te pranoje garanci reale ose personale ne favor dhe ne interes te paleve te treta dhe mund te marrin financime falas dhe pa pagese nga anetaret e saj, te gjitha sipas afateve dhe menyrave te ligjit dhe pa karakter prevalence, por vetem ne lidhje me arritjen e objektit dhe me perjashtimin e çdo veprimtari qe sjell mbledhjen e kursimit te tregut ose te nderhyrjes ne ndermjetesimin imobiliar, apo organizimin e tregjeve te transferuara ose ne çdo drejtim ne lidhje me publikun.

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjete mije) Leke.

5.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 2 (dy) kuota, te gjitha e nenshkruara dhe te shlyer.

**Neni 6 - Kontributet**

6.1. Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:

- Ortaku i shoqerise , **Z. Mario Gashi me numer personal ID J20817063C** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 5.000 Leke, nëpërmjet depozitimit prane nje banke ne Shqiperi.
- Ortaku i shoqerise , **Z. Toni Gashi me numer personal ID J90108050E** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 5.000 Leke, nëpërmjet depozitimit prane nje banke ne Shqiperi.



6.2. Sipas kontributeve te mesiperme:

- **Z. Mario Gashi** i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon me 50% (pesedhjet perqind) te kapitalit te Shoqerise.
- **Z. Toni Gashi** i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon me 50% (pesedhjet perqind) te kapitalit te Shoqerise.

#### **Neni 7 – Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

#### **Neni 8 – Administrimi**

- 8.1 Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator e cila eshte **Zj. Adelina Gashi**, shtetas Shqiptar, lindur me date 26.07.1971, ne Tirane, Shqiperi, mbajtese e kartës se identitetit Shqiptare me nr. H15726036I., i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese),vitesh.
- 8.2 Administratori do te ushtrojne te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare” dhe nenit 14 te Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te formalitetet e permbushjen e detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per kete qellim, Administratori, mund ti drejtohet per ndihme te treteve ose konsulenteve te cileve mund te delegojne ne teresi ose pjesisht kryrjen e aktivitetit te siperpermendur.
- 8.4 Administratori i deleguar eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai eshte gjithashtu i autorizuar, te firmosi te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te regjistrimit te saj si edhe ka te drejte t’i delegeje kompetencat e tyre personave te tjere.

#### **Neni 9– Gjuha**

9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

\* \* \*

**Ortaket e shoqerise/  
“Cloud Tech House” Sh.p.k.**

**Z Mario Gashi**

**Z Toni Gashi**

